



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.534/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat Anr.534/2025, Anr.549/2025 dhe Anr.550/2025 të datës 10.02.2025 të parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesat Anr.534/2025, Anr.549/2025 dhe Anr.550/2025 të datës 10.02.2025.

Në ankesën Anr. 534/2025 parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje pretendohet se, më datë 08.02.2025 kandidati për deputet i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, z.Lumir Abdixhiku në tubim elektorale me qytetarë në qytetin e Prishtinës, për qëllime politike ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese ndaj kundërshtarëve politik duke deklaruar me sa vijon: "Bizneset që 4 vite ndërtesën e Qeverisë e kanë pa si ndërtesë të shtypjes, frikës kërcnimit". Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: CD video deklarimi.

Në ankesën Anr.549/2025 pretendohet më 8 Shkurt 2025, Valon Rizani, mbështetës/simpatizant i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës ka postuar në llogarinë e tij në Facebook një fotografi të Kryeministrit Albin Kurti, me mbishkrimin "Partia Komuniste" në të cilën ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese për qëllime të fushatës dhe me qëllim të vazhdimit të dëmtimit elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit Albin Kurti. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë : Fotografi dhe CD ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxit, provokon akt të dhunës apo urrejtjes, në kundërshtim me LZP.

Në ankesën Anr.550 pretendohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit të tubimeve politike dhe fushatës zgjedhore, ka vërejtur gjuhë denigruese dhe fyese nga simpatizanti i LDK z. Bujar Gimolli, në rrjetin social facebook me emrin " Bujar Gimolli" e cila është ende aktive, ku ka përdorur gjuhë nxitëse ndaj subjektit politik LVV, e cila bie ndesh me neni 34 par 1 nën par 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Duke përdorur fjalinë "Niher thirrke me na mbyte si mizat, tash po na i kopjon gishtat. O mashtrus kot e ki. Numëroi orët e fundit se ece në Gerdoc ti. Njeri pa identitet.", kështu duke nxitur qytetarët kundër Lëvizjes Vetëvendosje dhe duke e fyer Kryeministrin e vendit z. Albin Kurt-i.Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD.

Në përgjigjen në ankesën Anr.534/2025 subjekti politik LDK ka theksuar se Kryetari i LDK-se z. Lumir Abdixhiku me rastin e thenies "Bizneset qe 4 Vite ndertesën e Qeverie e kane pa si ndertese te shtypjes, frikës, kërcënimit " nuk perben asnje shkelje të nenit 34 paragrafi I , nënparagrafi 1.1 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në rastin e ankimuar nuk kemi të bejme me asnje forme te gjuhes nxitese, provokuese që dërgon në akt dhune kundër personave tjere apo pasurise, e as gjuhe urrejtese ndaj te tjereve e as nxitese per urrejte ndaj dikujt apo dickaje, ne asnje forme apo rrethane.Shprehjet e tilla nuk kane lidhje me nxitje, provokim e urrejtje ndaj askujt, kujtdo apo dickaje. Eshte brenda komunikimit te lejuar politik, pa e cenu askend dhe asgje.

Në përgjigjen në ankesën Anr.549/2025 theksohet se Ne rastin e ankimuar nuk kemi te bejme me asnje forme te gjuhes nxitese, provokuese qe dergon ne akt dhune kunder personave tjere apo pasurise, e as gjuhe urrejtese ndaj te tjereve e as nxitese per urrejte ndaj dikujt apo dickaje, ne asnje forme apo rrethane.

Në përgjigjen për ankesën Anr.550/2025 theksohet se Ne rastin e ankimuar nuk kemi te bejme me asnje forme te gjuhes nxitese, provokuese qe dergon ne akt dhune kunder personave tjere apo pasurise, e as gjuhe urrejtese ndaj te tjereve e as nxitese per urrejte ndaj dikujt apo dickaje, ne asnje forme apo rrethanë.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesa të paraqitur nga subjekti LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i

refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesat nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 pika 1.11 të LZP-së e cila parasheh se “përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxis ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.” andaj Paneli vlerësoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me shprehje të pikëpamjeve individuale të kandidatit dhe mbështetësve/simpatizantëve të LDK-së të cilat pikëpamje nuk mund të quhen gjuhë fyese dhe nxitëse.

Parashtuesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, ka vërtetuar se në këtë rast nuk kemi shkelje të rregullave zgjedhore dhe shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.534/2025 datë 12.02.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.